



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më	
Nr.	prot.

Data: 25.2.2025

Nr: 188

Ora: 14:00

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN E RAPORTIT MBI VEPRIMTARITË PUBLIKE PËR PERIUdhËN 16 SHKURT-22 SHKURT 2025

Sot, më datë 25.2.2025, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me

OBJEKT: Shqyrtimi i raportit mbi veprimtaritë me karakter publik të disa institucioneve për periudhën 16 shkurt deri më 22 shkurt 2025.

BAZA LIGJORE: Nenet 19 pika 1, shkronja “n”, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

V E N D O S:

1. Miratimin e raportit të gjetjeve mbi veprimtaritë publike për periudhën 16 shkurt deri më 22 shkurt 2025, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Fillimin e shqyrtimit administrativ ndaj Bashkisë Elbasan.

Data: 25.2.2025 Nr: 188
Ora: 14:00



“Për shqyrtimin e raportit mbi veprimtaritë publike për periudhën 16 shkurt – 22 shkurt 2025”

3. Fillimin e shqyrtimit administrativ ndaj Bashkisë Tiranë.
4. Ky vendim njoftohet nëpërmjet postës elektronike.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Tiranë më	
Nr.	prot.

RAPORTI I GJETJEVE

MBI

VEPRIMTARITË ME KARAKTER PUBLIK TË DISA INSTITUCIONEVE, PËR PERIUdhËN 16 SHKURT- 22 SHKURT 2025

Në lidhje me raportimet e veprimtarive publike në Ndërfaqen e Raportimeve të Institucioneve (NRI), për periudhën 16 shkurt-22 shkurt 2025, konstatohet si vijon:

- 7 institucione publike të reja janë regjistruar gjatë kësaj periudhe në NRI, dhe kanë akses për raportimin e veprimtarive,
- **288 raportime** janë kryer në total,
- 278 postime janë aktive,
- **10 veprimtari janë të ndaluara**-nga të cilat për **5** veprimtari (nga 2 institucione) do fillojë shqyrtimi administrativ dhe për 5 veprimtari të tjera do bëhet **mosfillim shqyrtimi**.

Për datat **16 shkurt-22 shkurt 2025**, në ndërfaqen e raportimeve janë ndaluar **9** veprimtari të raportuara nga **5** institucione, për shkak të tejkalimit të afatit ligjor dhe **1** veprimtari (Bashkia Tiranë) është ndaluar për shkak të tematikës, si më poshtë vijon:

1. Bashkia Elbasan ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 4 (katër) veprimtari jashtë afatit të përcaktuar në nenin 92, pika 2, e Kodit Zgjedhor, me tematikë si më poshtë vijon:

- "Inspektim punimesh në lidhje me shkollën Tregan", raportuar në datë 16.02.2025 për t'u zhvilluar në datë 20.02.2025.
- "Mbjellje pemësh në Tregan", raportuar në datë 16.02.2025 për t'u zhvilluar në datë 20.02.2025.
- "Inspektim të punimeve në rrugën Tregan", raportuar më datë 16.05.2025 për t'u zhvilluar më datë 20.02.2025.
- "Takim me blegtorët e zonës të Njësisë Administrative Tregan", raportuar më datë 16.02.2025 për t'u zhvilluar më datë 20.02.2025.

2. Bashkia Tiranë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari me tematikë si më poshtë vijon:

- "Shpërndarje e apartamenteve nga programi 3%", raportuar në datë 17.02.2025 për t'u zhvilluar në datë 23.02.2025.

Veprimtaria e raportuar është në kundërshtim me nenin 92, pika 4, i Kodit Zgjedhor, i ndryshuar, dhe nenin 3, pika 1.3, shkronja "a" dhe "b", i Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit

Rregullator, i ndryshuar, për shkak të tematikës, dhe ka marrë shënimin “e ndaluar”, në sistemin elektronik të raportimeve (NRI).

Janë marrë masa për të njoftuar AMA-të mos lejojë transmetimin apo pasqyrimin në rubrikat e lajmeve apo ato që mbulojnë fushatën në radio dhe televizione, gjithashtu janë dërguar dhe monitorues për të vëzhguar nëse do të zhvillohet apo jo veprimtaria, në kundërshtim me vendimin e ndalimit.

Ngelemi në pritje të raportit të monitoruesit për shqyrtimin administrativ të veprimtarisë së raportuar.

3. Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari jashtë afatit të përcaktuar në nenin 92, pika 2, e Kodit Zgjedhor, me tematikë si më poshtë vijon:

- "COD-i në bashkëpunim me Universitetin Metropolitan Tirana, zhvillon edicionin e dytë të projektit “Robotech”, i cili ka në fokus zhvillimin e të rinjve të shkollave të mesme në fushën e teknologjisë dhe inovacionit, veçanërisht në aplikime të robotikës dhe inteligjencës artificiale", raportuar në datë 17.02.2025, për t'u zhvilluar në datë 17.02.2025.

Personi përgjegjës e ka riraportuar veprimtarinë në ndërfaqen e raportimeve më datë 17.02.2025, për t'u zhvilluar më datë 24.02.2025, me sqarimin se: “Në raportim të datës 17 është hedhur gabimisht data e zhvillimit të aktivitetit. Data e saktë e zhvillimit të aktivitetit është 24.02.2025 prandaj e rihedhim për raportim”.

Pasi verifikimeve rezulton se veprimtaria është riraportuar në datë 17.02.2025, për t'u zhvilluar më datë 24.02.2025. Në këto kushte nuk jemi para kundërvajtjes administrative.

4. Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 2 (dy) veprimtari jashtë afatit të përcaktuar në nenin 92, pika 2, e Kodit Zgjedhor, me tematikë si më poshtë vijon:

- "Zhvillimi i ciklit tre-ditor i trajnimeve të paketës së punës 2.2 të Projektit “Fuqizimi i menaxhimit të Riskut nga Fatkeqësitë në nivel lokal, Local – DRM”, në Qarkun Vlorë për stafin e Prefekturës Vlorë, Bashkisë Vlorë, Bashkisë Himarë dhe Selenicë”, raportuar në datë 17.02.2025 për t'u zhvilluar në datë 19.02.2025.
- “Zhvillimi i ciklit tre-ditor i trajnimeve të paketës së punës 2.2 të Projektit “Fuqizimi i menaxhimit të Riskut nga Fatkeqësitë në nivel lokal, Local – DRM”, në Qarkun Vlorë për stafin e Prefekturës Vlorë, Bashkisë Vlorë, Bashkisë Himarë dhe Selenicë”, raportuar në datë 17.02.2025 për t'u zhvilluar në datë 20.02.2025.

Personi përgjegjës për raportimet ka njoftuar nëpërmjet postës elektronike se: “Në vijim të raportimit të dy aktiviteteve të ndaluara nga KQZ gjatë ditës së djeshme, dëshirojmë të sqarojmë arsyet e kësaj shtate dhe hapat e mëtejshëm për zhvillimin e aktivitetit në fjalë. Për shkak të organizimit të trajnimit të paketës së punës 2.2 të Projektit “Fuqizimi i menaxhimit të Riskut nga Fatkeqësitë në nivel lokal, Local – DRM”, në Qarkun Vlorë, konfirmimi për zhvillimin e aktivitetit është marrë me vonesë. Si rezultat, raportimi i tij në KQZ u bë jashtë afateve të përcaktuara, çka çoi në ndalimin e zhvillimit të aktivitetit. Për këtë arsye, ky aktivitet është shtyrë për t'u zhvilluar në datat 26-28 shkurt. Gjatë ditës së sotme, aktiviteti është raportuar dhe konfirmuar nga KQZ, duke siguruar që të gjitha procedurat përkatëse janë respektuar.”

Pasi u verifikuan faktet e paraqitura prej Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, rezulton se janë riraportuar 2 veprimtari më datë 18.02.2025 për tu zhvilluar në datë 26.02.2025 dhe datë 27.02.2025, brenda afatit ligjor të përcaktuar nga Kodi Zgjedhor dhe Vendimi nr. 9 datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator, i ndryshuar. Në këto kushte nuk jemi para kundërvajtjes administrative.

5. Prefekti i Qarkut Elbasan ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari jashtë afatit të përcaktuar në nenin 92, pika 2, e Kodit Zgjedhor, me tematik si më poshtë vijon:

- Prezantimi i Prefektit të ri, Z. Ilir Bejtja”, raportuar më datë 20.02.2025 për t’u zhvilluar më datë 24.02.2025

Personi përgjegjës për raportimet ka njoftuar nëpërmjet postës elektronike se: *“Për sa më sipër ju bëj me dije se raportimi i parë nga ana jonë ishte një lapsus në vendosjen e datës. Nuk mundëm ta modifikonim raportimin ndaj realizuam një raportim të ri me datën e saktë të zhvillimit të aktivitetin që është data 25.02.2025”.*

Pasi u verifikuan faktet e paraqitura prej Prefektit të Qarkut Elbasan, rezulton se veprimtaria është riraportuar për tu zhvilluar në datë 25.02.2025, brenda afatit ligjor të përcaktuar nga Kodi Zgjedhor dhe Vendimi nr. 9 datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator, i ndryshuar. Kjo veprimtari është raportuar edhe nga Ministria e Brendshme dhe Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor si pjesëmarrës për prezantimin e Prefektit të ri, me datë zhvillimi 25.02.2025. Në këto kushte nuk jemi para kundërvajtjes administrative.

6. Bashkia Vlorë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari jashtë afatit të përcaktuar në nenin 92, pika 2, e Kodit Zgjedhor, me tematika si më poshtë vijon:

- “Takim me banorë të zonës Dukat për të diskutuar problematikat që kanë dhe investimet e Bashkisë Vlorë”, raportuar në datë 20.02.2025 ora 23:13 për t’u zhvilluar në datë 20.02.2025, ora 17:00.

Personi përgjegjës për raportimet ka njoftuar nëpërmjet postës elektronike se: *“Referuar konstatimit tuaj, po ju sqarojmë si më poshtë: Raportimi që kemi kryer ditën e djeshme për takim në zonën e Dukatit në datën 20.02.2025, është hedhur gabim nga ana jonë. Këtë takim e kemi riraportuar në datë 25.02.2025. Do t’ju luteshim të mos e merrnit të mirëqënë si raportimin e parë. Nuk ka patur asnjë takim të mbajtur nga Bashkia Vlorë në datën 20.02.2025 në zonën e Dukatit”.*

Pasi u verifikuan faktet e paraqitura prej Bashkisë Vlorë rezulton se veprimtaria është riraportuar për tu zhvilluar në datë 25.02.2025, brenda afatit ligjor të përcaktuar nga Kodi Zgjedhor dhe Vendimi nr. 9 datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator, i ndryshuar. Në këto kushte nuk jemi para kundërvajtjes administrative.

KQZ është në monitorim të vazhdueshëm të këtij procesi dhe në vijimësi do duhet që të gjithë institucionet shtetërore të kryejnë raportimet në lidhje me veprimtaritë që planifikohen të zhvillohen prej tyre, të paktën 5 ditë para zhvillimit të tyre dhe në përputhje me dispozitat e Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9/2020, të Komisionit Rregullator, të ndryshuar.